



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Tiranë, me 04.12.2018

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit Nr. 228 datë 04.12.2018 “Për pranimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2018 – 2019, ne Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), për lëndën “Ski” në Departamentin e Sportit, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, që duke filluar nga data 04.12.2018 deri më 10.12.2018, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

Departamenti i Sportit

- Ski (Bachelor) 1(një) As/ Lektor, Lektor

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shënuar qarte mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomën dhe Certifikatën e notave të studimeve Bachelor (fotokopje)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
- Certifikatën e gradës Doktor i Shkencave (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor (nqs ka) (fotokopje)
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punes per t’u angazhuar si pedagog i ftuar ne institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Drejtoria e Shëndetit Publik (dorëzohet nëse shpallet fitues)

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të ketë përfunduar studimet pranë Universitetit të Sporteve (Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes) me kohë të plotë.
- Nota e mesatare e ciklit të parë të studimeve (Bachelor) duhet të jetë mbi 8-të;
- Të zotërojë një gjuhë te huaj (preferohet gjuha angleze).
- Të ketë njohuri për njohjen e programeve bazë kompjuterike

- Të ketë së paku diplomën “Master i Shkencave”
- Kanë preferencë pedagogër më grada e tituj : Prof.Asc.Dr., Dr.
- Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të përputhet me lëndën mësimore që do të zhvillojnë sipas departamentit ku aplikon
- Preferohen pedagogët që kanë përvojë në mësimdhënie në shkollën e lartë.
- Të kete veprimtari shkencore si: referime, botime, studime.
- Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.

Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti ku konkuron, Departamenti, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail të konkurentit.

R E K T O R

Prof. Dr. Agron CUKA